

Klinika Stomatologjike Universitare njofton shpalljen e vëndit vakant në pozicionin Teknik/e

Aparaturash. Personat e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:

- Të ketë mbaruar Arsimin e Mesëm
- Të ketë përvojë pune në grup
- Të ketë eksperiencë pune në riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore dhe dentare të kryejë shërbime mirëmbajtjeje periodike të aparaturave çdo muaj.
- Të instalojë aparaturat e reja dhe të bëjë kolaudimin e tyre.
- Të këshillojë stafin për mirëmbajtjen dhe kujdesin e aparaturave
- Të sugjerojë kostot përkatëse për mirëmbajtjen e tyre.

Detyrat e teknikut të mirëmbajtjes së aparaturave:

- a. Të kryejë shërbime mirëmbajtjeje periodike të aparaturave çdo muaj.
- b. Të riparojë defektet e aparaturave sa herë paraqitet rasti.
- c. Të instalojë aparaturat e reja dhe të bëjë kolaudimin e tyre.
- d. Të këshillojë stafin për mirëmbajtjen dhe kujdesin e aparaturave
- e. Të përgatisë listën e pjesëve të këmbimit të domosdoshme për mirëmbajtjen e aparaturave çdo vit brenda tremujorit të parë të vitit.
- f. Të sugjerojë kostot përkatëse për mirëmbajtjen e tyre.

Kandidatët e interesuar do të sjellin pranë protokollit të Klinikës Stomatologjike Universitare dokumentat si më poshtë :

1. Dëshmi Penaliteti.
2. Dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës së huaj.
3. Kërkesë me shkrim për aplikim për punë.
4. Jetershkrim sipas formatit standart
5. Fotokopje të noterizuar të listes së notave.
6. Fotokopje e letërnjoftimit (*ID*).
7. Vërtetimin e gjendjes shëndetësore dhe për aftësinë për punë (*nga KML*).
8. Rekomandime, në rast se ka, mundësisht nga punëdhënësi i fundit

Mosparaqitja e plotë e dokumentave të sipërcituar brenda afatit të përcaktuar në shpallje, sjell skualifikimin e kandidatit.

Përzgjedhja e kandidatit do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi sipërcituar, aftësitë, **kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme,**

Për çdo paqartësi mund të dërgohet e-mail në adresën KSU@shendetesia.gov.al